



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Nr. 7773 Prot.

Fier, më 17.06.2026

Projekt - Vendim

Nr. 62 Dt. 17.06.2026

“Për miratimin në parim të vend-depozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte në territorin e Bashkisë Fier”

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më datë ____ .06.2026, i paraqitet për shqyrtim materiali i përgatitur nga Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Pronave, bazuar në kërkesat nr. 0306 prot. dt. 03.06.2026 e protokolluar në Bashkinë Fier me nr. 7162 prot. dt. 04.06.2026 dhe nr. 0806 prot. dt. 08.06.2026 e protokolluar në Bashkinë Fier me nr. 7371 prot. dt. 09.06.2026 të shoqërisë “DS DRILLING” sh.p.k. në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar nenin 9 pika 1.2, neni 28 pika 2, neni 54, shkronja “e/1”, neni 801-825 të K.Civil, ligjin nr. 10 463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, ligjit nr. 10 448 dt. 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ligjit 10 431 dt. 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, si dhe planet vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve të hartuara sipas ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, VKM 575 datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, i ndryshuar, VKM nr. 509 dt. 06.07.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njesisë Administrative Qendër Bashkia Fier Qarku Fier”, VKM Nr. 363 dt. 01.04.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njesisë Administrative Topojë Bashkia Fier Qarku Fier”, VKM 510 dt. 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në Njësitë e Qeverisjes Vendore, të prekura nga riorganizimi administrative – territorial”, VKM nr. 371, datë 11.6.2014, “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, VKM nr. 229, datë 23.4.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, Vendim i Këshillit Bashkiak Fier nr. 109 dt. 27.11.2025 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Fier për vitin 2026”, **Kryetari i Bashkisë;**

Propozon:

1. Miratimin në parim të vend-depozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte në territorin e Bashkisë Fier.
2. Ngarkohet ekzekutivi për vijimin e mëtejshëm të procedurave administrativo – ligjore sipas përcaktimeve ligjore.

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
Florjan Troka

Drejtoria e Hartimit të Projekteve dhe Kontrollit të Punëve Publike
Silvana Basha

Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Pronave
Mimoza Petushi

Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit
Pranvera Çina

Drejtoria Juridike
Esmeralda Kapllanaj

Sekretari i Përgjithshëm
Nikollaq NEÇO

KRYETARI

Armando SUBASHI

